



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetari i Komunës

01nr 400/05 8661

Dt: 05.04.2018

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 10 dhe 33 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të ZKKK-së me të cilin është miratuar kërkesa e z. Jakup Hasani nga Gjakova për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për strehimin e familjes së tij, me dt: 05.04.2018 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, e cila është e ndërlidhur me kërkesën nr. 16-360/06-3757 e dt:27.02.2018, e parashtruar nga z. Jakup Hasani nga Gjakova për mbulimin e shpenzimeve të qirasë së banesës në vlerë prej 50€ në muaj për periodën prej 6 muajve, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të ZKKK-së në vlerën totale prej 300€.
2. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerë prej 50€ në muaj për periodën prej 6 muajve, sipas kërkesës së ZKKK-së të parashtruar nga z. Jakup Hasani nr. 16-360/06-3757 e dt: 27.02.2018.
3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 50€ në muaj, përkatësisht vlerën totale prej 300€, nga mjetet e subvencioneve të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e qiradhënësit z. Ramë Imeraj me nr. 14020000225538564 Banka Ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Vendimi i'u dërgohet:
 - Kabinetit të Kryetarit të Komunës;
 - Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim;
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
 - Arkivit.



Kryetari i Komunës

Ardian Gjini
Ardian Gjini